

Rihapen aplikimet për programin “SUBVENCIONI I INTERESAVE TE KREDISE” 2025

Pavarësisht zbatimit me sukses të këtij programi ka ende kuota të lira për vitin 2025. Programi i strehimit social “Subvencionimi i interesave të kredisë” u shërben familjeve ose individëve që nuk janë në gjendje ekonomike e sociale të përballojnë ofertën e tregut të lirë të banesave ose atë të kredive hipotekore. Prioritet u jepet çifteve të reja, grave kryefamiljare apo individëve e familjeve të minoritetit rom e egjiptian.

Aplikimet do të jenë në dy faza. E para realizohet përmes portalit qeveritar “eAlbania” brenda 15 ditëve kalendarike nga data 20.05.2025 deri me date 05.06.2025. Në portal, qytetarët duhet të aplikojnë duke zgjedhur shërbimin “Kërkesë për të përfituar nga programet e strehimit social”.

Vetëm ata që kalojnë me sukses fazën e parë, duhet të depozitojnë pranë zyrave të Bashkisë Rrogozhinë, formularin e strehimit të plotësuar elektronikisht në portalin “e-Albania”. Kjo duhet të bëhet brenda 15 ditëve kalendarike, shoqëruar me dokumentacionin e kërkuar. Në lidhje me këto të fundit, të vlefshme do të konsiderohen dokumentet që janë lëshuar nga institucionet kompetente jo më herët se 3 muajt e fundit.

Individi/ familja që ka paraqitur të dhëna të pavërteta ose të pasakta, ose në kundërshtim me kushtet dhe kriteret e parashikuara në ligjin në fuqi për strehimin social dhe aktet nënligjore për zbatim të tij, i hiqet e drejta për të përfituar.

Ju faleminderit për mirëkuptimin, Drejtoria e Mbrojtjes dhe Shërbimit Social!